



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.121/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.121/2025, e datës 06.10.2025.
- II. Subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00, (pesëqind) Euro.
- III. Detyrohet Subjekti Politik, Srpska Lista që gjobën e shqiptuar si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Srpska Lista ku pretendon se më datë 04.10.2025, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) vunë re se subjekti politik Srpska Lista në fshatin Kuzmin, Komuna Fushë Kosovë ka ngjitur materialin e tyre promovues në një shtyllë elektrike, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore nr.7/2024. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 34 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili parashikon se materialet zgjedhore mund të vendosen vetëm në hapësira të përcaktuara nga komuna dhe me leje paraprake, si dhe me nenin 7 paragrafi 2, Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024. Me tutje në ankesë kërkohet nga

PZAP që të konstatojë shkeljen e bërë nga subjekti politik Srpska Lista dhe të ndërmarrë masat e parapara ligjore, duke përfshirë urdhrin për largimin e menjëhershëm të materialeve të vendosura në mënyrë të kundërligjshme dhe shqiptimin e sanksioneve administrative. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me rregulloren zgjedhore.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Srpska Lista theksojnë se përkrahësit kishin vendosur material promocional në një baner në Rr. “Dimitrije Tucovic” në Kuzmin. Dëshirojnë të theksojnë se menjëherë pasi kishin marrë informacion se ishte paraqitur ankesë, kishin ndërmarrë masa korrigjuese dhe kishin hequr materialin e përmendur. Me tutje në përgjigje theksojnë se si subjekt politik përgjegjës në kemi hequr materialin promocional të përmendur në përputhje me Rregulloren Zgjedhore nr.1/2025, Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, ku në nenin 11 thotë: Para shpalljes së dënimit, PZAP mund të kërkojë nga pala kundër së cilës është paraqitur ankesa që ajo të ndërmarrë masa korrigjuese për heqjen shkeljes brenda një afati që cakton PZAP. Bazuar në nenin 118 të Ligjit nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, propozojnë që PZAP të pranojë përgjigjen ndaj ankesës sit ë bazuar, dhe të hedhë poshtë ankesën e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV). Si provë në përgjigje në ankesë e kanë bashkëngjitur largimin e posterëve/banereve nga shtylla elektrike.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa-PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës, provave të bashkangjitura ankesës dhe përgjigjes në ankesë, vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, vlerëson se pretendimet e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Srpska Lista, për faktin se e njëjta më datë 04.10.2025, është vërejtur se nga subjekti ankues se Srpska Lista ka vendosur banerë/poster në shtyllë elektrike, në Rr. “Dimitrije Tucovic” në fshatin Kuzmin, Komuna e Fushë Kosovës, fakt ky i pranuar nga përgjigja në ankesë, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli vlerëson se Subjekti Politik Srpska Lista ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, prandaj vendosja e posterëve-njoftimeve të subjektit të tyre politike për fushatë zgjedhore në objekte publike, gjegjësisht në shtyllë elektrike në fshatin Kuzmin, Komuna e Fushë Kosovës, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjtat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobave si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor, shkallën dhe peshën e shkeljes. Po ashtu Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ndaj subjektit politik Srpska Lista, si rrethanë lehtësuese ka marr faktin se i njëjti ka larguar posterin nga vendi ku ishte vendosur, përkatësisht, shtylla elektrike, që tregon se është bërë përpjekje serioze për evitimin e shkeljes së bërë, si dhe praktikën e PZAP-it, për rastet të ngjashme, të vendosura në PZAP.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së, ku përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të qëndrueshme dhe të bazuara dhe si të tilla i pranoj, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL-Anr.121/2025 datë 08.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.